



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM
PËR TË APLIKUAR PËR MONITORUES

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, “Për përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, si dhe vendimit nr. 203, datë 6.12.2024, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të caktojë monitorues sipas qarqeve si më poshtë vijon:

STRUKTURA ORGANIKE	QARKU	VENDE PUNE	DETYRAT KRYESORE
Sektori I Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit të Fushatës	Qarku Berat	3	a. Vëzhgimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të partisë politike, subjektit zgjedhor, kandidatëve, dhe të organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, si dhe titullarëve të tyre;
	Qarku Dibër	3	
	Qarku Durrës	7	
	Qarku Elbasan	11	b. Intervistat me kandidatët ose kryetarët/përfaqësuesit e partive politike, drejtuesit e fushatës së partive politike/subjekteve zgjedhore si dhe stafit mbështetës të tyre;
	Qarku Fier	10	
	Qarku Gjirokastrë	6	c. Identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të zyrave zgjedhore dhe të materialeve propagandistike;
	Qarku Korçë	8	
	Qarku Kukës	3	
	Qarku Lezhë	4	
	Qarku Shkodër	9	d. Identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale të partive politike, subjektet zgjedhore dhe kandidatët.
	Qarku Tiranë	22	
	Qarku Vlorë	10	



KRITERET E APLIKANTËVE:

- 1) Të jetë i padënuar,
- 2) Të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë.
- 3) Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit



Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë aplikantët për pozicionin e punës, monitorues:

- a) Kërkesën për t'u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
- b) **Pashaportizimin,**
- c) Dëshmi penaliteti,
- d) Kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit,
- f) Vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhët udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
- g) Raport të aftësisë për punë,
- h) Fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).

AFATI PËR DORËZIM E DOKUMENTEVE:

26.12.2024

MËNYRA E APLIKIMIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIN DO TË JETË

-  Me anë të postës zyrtare në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë.
-  Pranë institucionit të KQZ-së, në adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë